


The Worcester Public Schools is an Equal Opportunity/Affirmative Action Employer/Educational Institution and does not discriminate regardless of race, color, gender, age, religion, national origin, marital status, sexual orientation, disability, or homelessness. The Worcester Public Schools provides equal access to employment and the full range of general, occupational and vocational education programs. For more information relating to Equal Opportunity/Affirmative Action contact Stacy DeBoise Luster, Human Resource Manager, 20 Irving Street, Worcester, MA 01609, 508-799-3020. Please call the main office at the school if you would like this document translated into a language other than English. For favor, contate a secretaria central da escola caso deseje que este documento seja traduzido para o português. Por favor, llame a la oficina central de la escuela si usted desea que este documento sea traducido al español. Ju lutem telefononi zyren gendrore te shkollës ne se dëshironi ta keni këtë dokument në përthyer në një gjuhë tjetër përvec Anglishtes Xin góti diên thoai cho vãn phòng nhà trường nếu quý vi muốn tài liệu này được dịch ra một ngôn ngữ khác hơn tiếng Anh



Shkollat Publike Worcester

Duke u Bere Gati per Shkollë

Keshilla per Prinder



ALBANIAN

- ◆ Ndhimo femijen tend, qe te jete i gezuar per fillimin e nje shkolle te re. Bisedo shpesh per ti treguar femijes tuaj, se sa mire eshte te shkosh ne nje “shkolle te madhe”, trego gjithashtu dhe per aktivitet, qe ai/ajo do te beje atje. Kjo do ta ndihmoje femijen tuaj gjate periudhes se tranzicionit.
- ◆ Tregoi shpesh femijes, se sa krenar jeni ju, qe ai/ajo po rritet, sa i kenaqur jeni ju, qe femija eshte ne gjendje te beje shume gjera vete, dhe sa mire ai/ajo do kryej mesimet ne shkollen e re. Kjo e ndihmon femijen per te pasur besim tek vetja, rreth eksperiencave te reja qe e presin.
- ◆ Vendose femijen ne nje situatë te tille, ku ai/ajo ka nevoje te ndjeki udhezime – ne fillim nje hap, pastaj dy, pastaj tre. Mesoje femijen, qe te ushtrohet me udhezimet, ne menyre qe ti mbaje mend ato.
- ◆ Ndhimoje femijen, qe te mesoje te kujdeset per vehten, si te lahet vete, te laje duart, te mbylli kopsat dhe zinxhirin.
- ◆ Vendose femijen ne nje situatë te tille, ku ai/ajo nuk eshte ne gjendje te kryej nje pune dhe i duhet te kerkoje ndihme. Ne qofte se femija nuk di se si te kerkoje ndihme, atehere demostroje vete ate veprim me kujdes dhe prit, qe femija te te imitoje ty, para se ta ndihmosh.
- ◆ Lexo libra me femijen cdo dite. Bisedo me ate rreth fotografive dhe ngjarjeve. Ne se femija nuk pelqen te qendroje per nje kohe te gjate ulur, atehere lexo cdo dite per nje kohe te shkurter; edhe n. q. se ju keni vetem dy minuta kohe, beheni ate sa me terheqese. Ju do te shikoni, qe interesi i femijes do te rritet.
- ◆ Shih TV me femijen, sidomos cfaqje, si “Between The Lions” dhe “Sesame Street”. Bisedoni se bashku per ato, qe ju shihni ne TV.
- ◆ Lere femijen te ndihmoje ne larjen e rrobave, shtrimin e tavolines, gatim, pjekje, vendosjen e ushqimeve, sistemimin e librave dhe lodrave te tij/saj. Te gjitha keto lloj punesh kane lidhje me aftesite ne shkolle.
- ◆ Mesoje femijen te beje pune te thjeshta ne shtepi. Shumica e femijeve te vegjel mund te mesojne te varin pallton dhe te rregullojne krevatin e tyre. Eshte mire te kesh ne shtepi nje “kuti per shkollen”, ku femija te vendose ne menyre te rregullt shkumesat, gersheret, lapsat dhe gomen. Lere femijen te ndihmoje ne punet e lehta te shtepise. Keto pune shume praktike, gjithashtu zhvillojne koordinimin fizik te femijes.
- ◆ Sigurohu, qe femija te kete shume mundesi per te vrapuar, kercyer, hedhur, kacavirur dhe per te luajtur jashte. Keto aktivitete mund te behen ne lagjen e nje qyteti, ne nje zone te sigurt ose ne nje park: zakonisht ato nuk behen brenda ne shtepi! Femijet, te cilet kane mesuar te kontrollojne trupin e tyre ne nje hapësire, kane me shume vetbesim ne situata te reja, dhe jane me te afte per te kryer pune te tjera me komplekse, si p.sh. te ecin ne nje vije te drejte.
- ◆ Cdo kohe, mesoje femijen te kryeje nje detyre te re, ndaje ate ne pjese te vogla, dhe mesoje femijen te kryeje cdo pjese te saj (per shembull, te ulet ne tavoline, te marre lodrat). Shperbleje femijen per cdo detyre, qe ai/ajo e kryen me sukses. Shume pak njerëz i vleresojne femijet shume per ate qe bejne; shumica prej nesh i vleresojne ata shume pak.
- ◆ Kur shkoni ne ndonje vend me femijen, bisedo rreth atyre, qe ju shikoni. Ver ne dukje karakteristika (ngjyra, masa, forma) dhe emrat e objekteve qe shikoni. Perpiqu te bisedosh me femijen, sikur bisedon me nje te rritur, ne vend qe ta pyesesh vazhdimisht (“oh, shiko ate shtepine e kuqe,” ne vend te “cfare ngjyre eshte kjo shtepi?”; “Mua me pelqen me shume kungulli i MADH – ke pelqen ti?” ne vend te “me trego kush eshte me i madhi”).
- ◆ Kur ktheheni ne shtepi, pasi keni qene ne nje dyqan, librari ose mbremje, kerko qe femija ti tregojte anetareve te tjere te familjes, per ato qe ju bete ose pate atje. Ne se femija ka veshtiresi ne ritregimin e ngjarjes, atehere mbeshtete qe te tregojte ngjarjen. Kjo aftesi quhet *rimodelim*. Kjo eshte e lidhur ngushte me kuptimin e leximit.
- ◆ Ver ne dukje, germa, fjale dhe numra ne ambientin rrotull femijes. (McDonald’s, numrat e shtepive, emrat e anetareve te familjes ne shkronja). Kjo do te siguroje bazat per mesimin e simboleve ne lexim.
- ◆ Shpesh here numuro *objekte*, dhe preki ato nderkohe qe thua numrat. Kjo do te ndihmoje femijen per te kuptuar, qe numrat perfaqesojne bashkesi *sendesh*.
- ◆ Bisedo shpesh rreth puneve interesante, qe femija mund te kete kur ai/ajo te rritet - por jo rreth parave qe mund te marre ne pune. Gjithashtu beji te ditur femijes, qe shumica e puneve kerkojne te punosh fort dhe te dalesh mire me mesime ne shkolle.
- ◆ Mesoje femijen te vleresojte, qe cdo person eshte unik dhe i vecante; qe diferencat midis njerëzve jane nje pjese e mrekullueshme e botes, dhe jo kercenim; dhe qe te gjithë njerëzit duhet te ndihmojne te tjeret, si dhe te ndihmohen NGA te tjeret, ne menyre qe te bejne nje jete te lumtur.
- ◆ *Gezoju* kohes qe shpenzon me femijen tend .Pikpamjet pozitive dhe me besim rreth njerëzve dhe botes, qe femija juaj meson sot, do te mbeten tek ai/ajo gjate gjithë jetes.

